



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 3115/5 Prot.

Pogradec, më 16.07.2024

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Znj.MANJOLA KAMOLLI KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po iu dërgojmë projekt vendimin dhe relacionin shoqërues, për:

PËR NJE RISHPERNDARJE NË VENDIMIN NR 140 DT 28.12.2023, PËR MIRATIMIN DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN 2024"

Me respekt,

KRYETARI
Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 5

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin:



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2024

PROJEKT-VENDIM

NR. _____, DATË ____ . ____ .2024

PËR

**NJE RISHPERNDARJE NË VENDIMIN NR 140 DT 28.12.2023, PËR MIRATIMIN DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN 2024"**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar dhe ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare" i ndryshuar, Ligji 97/2023 "Per buxhetin e vitit 2024", pika II.3 nr 100 e Udhezimit te MF nr 9 dt 20.03.20218 " Per procedurat te zbatimit te buxhetit", pika 2 e Udhezimit nr 1 dt 24.01.2024 " Per zbatimin e buxhetit te vitit 2024" dhe VKB 140 dt 28.12.2023 " Miratimin dhe detajimin e buxhetit të bashkisë Pogradec për vitin 2024", Shkresa nr 1815/5 dt 27.03.2024 " Transferim fondi për shpenzimet kapitale", Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:



1. Te miratoje rishperndarjen e Fondeve të vitit 2024 si më poshtë:

1.1 Pakesohet

Enti	Ministria	Kodi	Kapitull	Prog	Llogaria	Kodi Deg.		Kod	Emertim Projekti
Qeverisje	Linjes	Institucion			Ekonomike	Thesarit	Shuma	Projekti	
136	00	2136001	05	01110	6020000	1529	8,500,000		KF Pogradeci SHA
136	00	2136001	01	01110	2310000	1529	1,500,000		Projektme 2024
							10,000,000		

1.2 Pakesohet

Enti	Ministria	Kodi	Kapitull	Prog	Llogaria	Kodi Deg.		Kod	Emertim Projekti
Qeverisje	Linjes	Institucion			Ekonomike	Thesarit	Shuma	Projekti	
136	00	2136001	05	04260	6020000	1529	8,500,000		Sherbim dru zjarri
136	00	2136001	01	04260	6020000	1529	1,500,000		Sherbim dru zjarri
							10,000,000		

2. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Kryetari i Bashkise, te gjitha drejtorite, Ndermarrjet ne varesi pranë Bashkise Pogradec.

3. Vendimi të hyjë në fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETAR

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.____.2024

Relacion

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar dhe ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare" i ndryshuar, Ligji 97/2023 "Per buxhetin e vitit 2024", pika II.3 nr 100 e Udhezimit te MF nr 9 dt 20.03.20218 " Per procedurat te zbatimit te buxhetit", pika 2 e Udhezimit nr 1 dt 24.01.2024 " Per zbatimin e buxhetit te vitit 2024" dhe VKB 140 dt 28.12.2023 " Miratimin dhe detajimin e buxhetit të bashkisë Pogradec për vitin 2024", paraqesim perpara jush këtë projekt vendim për rishpërndarjen e fondeve të viti 2024.

Tek tabela 1.1 zërat e shënuara janë miratuar për vitin 2024. Zëri shpenzime për FK Pogradeci SHA do të rishpërndahen për shkak të shitjes së aksioneve. Gjatë vitit 2024 janë shpenzuar 26,500,000 lekë për FK Pogradeci SHA dhe pjesa e mbetur po rishpërndahet. Gjithashtu nga zëri Projektme 2024 i cili nuk është përdorur akoma do të heqim nga fondi 1,500,000 lekë.

Tabela 1.2 ka të bëjë me fondet të cilat janë të nevojshme për prokurimin publik Shërbim dru zjarri në shumën 10,000,000 lekë. Në VKB 54 dt 30.04.2024 kemi miratuar fondin prej 1,765,000 lekë për Shërbimin e druve të zjarrit. Shuma totale për këtë prokurim është rreth 12,000,000 lekë. Më poshtë po ju paraqesim përlllogaritjet e fondit.

Bazuar në pikën 2, neni 27, të ligjit nr 57/2020, "Për pyjet, në shkronjën (a) dhe)c) të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 5/2016, datë 04.02.2016, "Per shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë", të Kreu II, "Përkufizime", pikave 1, 2 dhe 18, Kreu III dhe pikës 26, Kreu V, të VKM nr.438, datë 08.06.2016, "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore dhe jo pyjore, i ndryshuar, Drejtoria e Shërbimit Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave ka Miratuar projektet për mundësinë vjetore të shfrytëzimit të lëndës drusore në sasinë **536 m³**, dru zjarri në ngastrat **nr.8a, 11a, 26a, 20a, dhe 29c**, të ekonomisë pyjore "**Guri i Nikës**", si dhe **1160 m³** në **Ekonominë Pyjore Bishnicë Pjesa Ekonomike Talle** në ngastrat **16/a; 13/b**. Kjo sasi është e planifikuar për vitin pyjor 2024 – 2025, për plotësimin e nevojave të komunitetit dhe enteve publike si: Shkolla, Kopshte, Çerdhe me dru zjarri për ngrohje, nëpërmjet ndërhyrjeve "rigjeneruese", (proçes i sigurimit të gjeneratës së re të pyllit, i cili sigurohet në rrugë natyrore dhe/ose nëpërmjet ndërhyrjes me shfrytëzim selektivë (të përzgjedhur) të pyllit dhe "**shëndetësore**", (proçesi i trajtimit të pyllit nëpërmjet ndërhyrjeve me metoda teknike, duke eliminuar drurët, të cilët shfaqin shenja të dëmtimit (natyror ose



artificial, të prekur nga sëmundje dhe të dëmtuar nga shkaqe natyrore dhe duke garantuar vijimësinë e grumbullit, nëpërmjet drurve të shëndetshëm), sipas projekt vlersimit që është realizuar.

Referuar nevojave të enteve publike për dru zjarri e cila fillon në 15 nëntor – 15 mars me një sasi totale 2400 mst, çdo vit Drejtoria e pyjeve planifikon sasinë e materialit drusor për të përmbushur nevojat e enteve publike, e cila Ngastrat që trajtohen me prerje rigjeneruese, konfrom legjislacionit për pyjet në fuqi sasia që pritët miratohet me Urdhër Ministri.

Pasi miratohet vijohet procedura e analizave operacionale në proceset e punës si: Prodhimi i druve të zjarrit me motorsharre, transporti i brendëshem me kasfshë drejt shesheve të depozitimit, pastrimi i degve, beturinave gjatë shfrytëzimit, kostot e transportit, carje, ngarkim, stivim etj për shfrytëzimit e lëndës drusore sipas manualeve të pyjeve duke ju përmbajtur projektit teknologjik., dhe vlera e preventivit do të jetë objekt i procedurave të prokurimit publik e cila jepet në preventivat e mëposhtëm.

Subjekti që fiton të drejtën në procedurat e prokurimit publik, plotëson nevojat sipas grafikut të shpërndarjes të parashikuar në kontratë, duke përfshirë të gjitha operacionet e punës, dhe monitorohet nga Drejtoria e Pyjeve mbi proceset e punës.

Sasia që do të prokurohet këtë vit do të jete 2825 mst të llojit pyjor Fagus Sylvatica, me vlerë totale për të dy pjesët 11.539.195 lek me TVSH, planifikojmë më tepër për arsye të rasteve të kushteve klimaterike në dimër të acartë dhe lind nevoja për një muaj shtese për plotësimin me dru zjarri.

PREVENTIV

(përmbledhëse)

PËR PRODHIMIN, TRANSPORTIN, STIVIMIN, SHARRIMIN DHE ÇARJEN E DRUVE TË ZJARRIT

Ngastra 8a, 11a, 20a, 26a, 29c (Guri i Nikës) Sasia = 893 mst

Nr.	Nr. Operacionit të punës (sipas librit të normave)	Emërtimi i proceseve të punës	Njësia e matjes	Sasia	Çmimi për njësi (leke)	Vlera (leke)
I.		Prodhimi, transporti me kasfshë dhe pastrimi i ngastrës				
1		Preventivi nr. 1, ngastra 8a	mst	236.7	2160	511272
2		Preventivi nr. 2, ngastra 11a	mst	263	2051	539413
3		Preventivi nr. 3, ngastra 20a	mst	131.6	2302	302943
4		Preventivi nr. 4, ngastra 26a	mst	211.7	2127	450286
5		Preventivi nr. 5, ngastra 29c	mst	50	2841	142050
		Shuma e I-rë		893		1945964
II.		Ngarkim, stivim dhe sharrim				
1	92	Ngarkim dru zjarri me krahë në automjet	mst	893	140	125020
2	114	Stivim dru zjarri me krahë	mst	893	76	67868
3	Analizë	Sharrim dru zjarri me motosharrë në fushën e druve	mst	893	165	147345
		Shuma e II-të				340233
III.		Transporti me automjet				
1	"	Në fushën e druve (Sasia 893 mst) (dm=46.5 km x 893 mst x 0.41 Ton/mst=17025Ton x km)	T x km	17025	23.5	400088



400088

		Shuma e III-të				
IV.		Çarje dru zjarri për shkollat dhe kopshtet				
	Analizë	Çarje dru zjarri me vegla dore 893 mst	mst	893	254	226822
		Shuma e IV-et				226822
		Shuma (I +II +III +IV)				2913107
		Fondi rezervë	%	5		145655
		Totali				3058762
		TVSH	%	20		611752
		TOTALI I PREVENTIVIT				3670514

PREVENTIV

(përmbledhëse)

PËR PRODHIMIN, TRANSPORTIN, STIVIMIN, SHARRIMIN DHE ÇARJEN E DRUVE TË ZJARRIT
Ngastra 13b, dhe 16a (Tallë) Sasia = 1932 mst

Nr.	Nr. Operacionit të punës (sipas librit të normave)	Emërtimi i proceseve të punës	Njësia e matjes	Sasia	Çmimi për njësi (leke)	Vlera (leke)
I.		Prodhimi, transporti me kafshë dhe pastrimi i ngastrës				
1		Preventivi nr. 1, ngastra 13b	mst	991	1786	1769926
2		Preventivi nr. 2, ngastra 16a	mst	941	1852	1742732
		Shuma e I-rë		1932		3512658
II.		Ngarkim, stivim dhe sharrim				
1	92	Ngarkim dru zjarri me krahë në automjet	mst	1932	140	270480
2	114	Stivim dru zjarri me krahë	mst	1932	76	146832
3	Analizë	Sharrim dru zjarri me motosharrë në fushën e druve	mst	1932	165	318780
		Shuma e II-të				736092
III.		Transporti me automjet				
1	Analizë Nr. 90 (3.an.54/a')	Njësia Administrative Velçan (Sasia 140 mst) (dm=22 km x 140 mst x 0.41 Ton/mst=1262 Ton x km)	T x km	1262	35.3	44549
2	"	Njësia Administrative Proptisht (Sasia 312 mst) (dm=30 km x 312 mst x 0.41 Ton/mst=3837 Ton x km)	T x km	3837	35.3	135446
3	"	Njësia Administrative Trebinjë (Sasia 204 mst) (dm=36.1 km x 204 mst x 0.41 Ton/mst=3019 Ton x km)	T x km	3019	35.3	106571
4	"	Njësia Administrative Dardhas (Sasia 160 mst) (dm=86 km x 160 mst x 0.41 Ton/mst=5641 Ton x km)	T x km	5641	35.3	199127
5	"	Njësia Administrative Çërravë (Sasia 448 mst) (dm=90 km x 449 mst x 0.41 Ton/mst=16568 Ton x km)	T x km	16568	35.3	584850
6	"	Në fushën e druve (Sasia 668 mst) (dm=78.2 km x 668 mst x 0.41 Ton/mst=21417 Ton x km)	T x km	21417	35.3	756020
		Shuma e III-të				1826563
IV.		Çarje dru zjarri për shkollat dhe kopshtet				
	Analizë	Çarje dru zjarri me vegla dore 668 mst	mst	668	254	169672
		Shuma e IV-et				169672
		Shuma (I +II +III +IV)				6244985



		Fondi rezervë	%	5	312249
		Totali			6557234
		TVSH	%	20	1311447
		TOTALI I PREVENTIVIT			7868681

(Sipas Standartit Shteteror STASH 732 – 88, vëllimi 10, libri 1, viti 1989), si më poshtë :

parametrat teknik: Kerkesat teknike:

- Drutë e zjarrit janë për nevojat e Bashkisë Pogradec .
- Drutë e zjarrit duhet të jenë me gjatësi nga 95 - 105 cm.
- Drutë e zjarrit duhet të jenë minimum me diametër 3 cm nga pjesa e hollë dhe maksimumi sa është diametri i drurit.

Referuar V.K.M Nr.438, datë 8.6.2016, "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore", si më poshtë:

- Fillon prerjen e drurëve të secilës pjesë, pas pajisjes me lejen përkatëse të shfrytëzimit të lëshuar nga Sektori i Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Pogradec, pavarësisht nga procesverbali i marrjes në dorëzim.
- Brenda ngastrës nën/ngastrës që ka marrë në dorëzim, respekton afatet e punimeve për prerjen, prodhimin, pastrimin e ngastrës, kolaudimin provizor e atë përfundimtar dhe evadimin e materialit drusor.
- Nxjerr çdo ditë në anë të rrugës, asortimentet, drutë e zjarrit çdo 7 ditë duke i stivosur ato në anë të rrugës; stivat shënohen me gëlqere ose bojë vaji të dallueshme, ku shënohet edhe sasia përkatëse.
- Dorëzon materialin drusor të prodhuar në shesh depozitim Brenda orarit zyrtar sipas asortimenteve dhe pas marketimit të tyre bën transportin me vërtetim transporti.
- Deklaron çdo fillim muaji në sektorin pyjor numrin e mjeteve, tipin e targën e tyre, me të cilat do të bëjë transportin e materialit drusor.
- Pajiset me vërtetim transporti për çdo ngarkesë e mjet transporti pas plotësimit të dokumentit shoqërues të mallit.
- Raporton me shkrim dhe bën rakordimet me Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave, pranë Bashkisë, çdo 15 ditë për sasinë e materialit drusor të prodhuar, atij që është gjendje brenda në ngastrë, që është sistemuar në rrugë auto dhe të transportuar.
- Mbron sipërfaqen që shfrytëzon nga prerjet abuzive e zjarret dhe mban përgjegjësi ligjore për dëmtimet e saj.
- Merr pjesë aktive me forcat dhe mjetet e veta për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, që ndodhen në ekonominë pyjore ku ushtron aktivitetin.
- Bën sigurimin teknik të punonjësve të tij. Mban përgjegjësi ligjore për mbrojtjen dhe sigurimin në punë të punonjësve të vet. Për çdo ngjarje e aksident në ngastrën pyjore ku ai punon merr masa, ndërpret menjëherë punën dhe njofton Autoritetet përkatëse.
- Materiali drusor që do të prodhohet do të jetë në funksion të Ligjit Nr.5/2016, "për moratoriumin në pyje" shkronja "a" dhe "c", të pikës 1 Neni 3.



- Deklaron me përgjegjësi çdo fund muaji në tatim-taksa të punësuarit e tij dhe derdh për ta, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.
- Drutë duhet të dorëzohen dhe të sistemohen me qëllim matjen e tyre.
- Drutë duhet të jenë të stivosura në objekt në **meter stere** dhe do të merren në dorëzim sipas grafikut të nënshkruar midis operatorit ekonomik dhe AK-se, brenda orarit zyrtar.
- Në rast se malli objekt prokurimi (dru zjarri) nuk plotëson kërkesat, nuk do të merret në dorëzim.
- Dorëzimi i druve të zjarrit bëhet në Shesh depozitimin e përcaktuar nga Bashkia.
- Trajtimi me prerje fillon nga lart-poshte dhe asnjëherë nga poshtë-lartë, duke zbatuar të gjitha rregullat e sigurimit Teknik dhe të mbrojtjes në punë.
- Drurët me diametër deri 15cm priten rrafsh me sipërfaqen e tokës dhe kur diametri i tyre është mbi trashësinë 15cm, lartësia e cungjeve mbi sipërfaqen e tokës, nuk duhet të jetë më shumë se 1/3 e diametrit. Gjatë prerjes e rrëzimit të drurëve, ruhet gërma e numri i damkës.
- Krahas prodhimit dhe transportit të brendshëm, kryhet pastrami i degëve dhe ai natyror, duke I vendosur në togje në largësi 30-40m larg njëri-tjetrit apo në pjesë të rezikuara nga erozioni, përfundon deri 30 ditë pas përfundimit të prerjes.
- Materjali drusor i prerë që ndodhet Brenda ngastrës, pas afatit përfundimtar të prerjes, nxjerrjes, pastrimit dhe kolaudimit të ngastrës, të përcaktuar në kontratë, si dhe pas mbarimit të afatit të përcaktuar, vihen në ruajtje në ngastër dhe vlera e prodhimit nuk i paguhet subjektit të kontraktuar. Ky materjal vlerësohet dhe bashkia mund të kontraktojë subjekt tjetër për nxjerrjen e tij.
- Për detaje më të veçanta do të përcaktohen në kontratën objekt prokurimi me operatorin ekonomik të shpallur fitues.

Ju faleminderit!

Konceptoi : I. Karapança

K.Lufo

Miratoi: D.Babasuli

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**